



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu, 60000, Gjiilan, Kosovë
www.uni-gjiilan.net tel: 0280-390-112

SYLLABUS

Lënda: FINANCAT PUBLIKE

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Ekonomik
Titulli i lëndës:	FINANCAT PUBLIKE
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	viti i III-të, semestri i VI-të
Numri i orëve në javë:	2 + 1
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	UKZ
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Ass. Dr. Refik Kryeziu, Asistent: Mr.sc Nexhat Shkodra
Detajet kontaktuese:	044-230-972. refik_kryeziu@hotmail.com
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i kursit të lëndës është që studentët të marrin dije dhe njohuri të bollshme për kuptimin, konceptet, karakteristikat dhe funksionimin e financave shtetërore, ndër të cilat mbi: 1. Kuptimin, definimin, karakteristikat dhe rëndësia e financave publike. 2. Shpenzimet publike, politika e shpenzimeve publike, struktura e tyre dhe plotësimin e nevojave. 3. Të ardhurat publike, llojet e tyre, instrumentet e të ardhurave, si: tatimet, dogana, taksat, kontributet etj. 4. Buxhetin shtetëror, sistemin buxhetor, funksionet, parimet dhe procesimin e buxhetit, 5. Borxhin publik si dhe 6. Nndikimi dhe roli i financave publike në zhvillimin ekonomik. Në aspektin e veçantë qëllimi është që studentët të mësojnë për funksionimin e financave publike në Republikën e Kosovës dhe në Republikën e Shqipërisë si dhe përcaktimin e dallimeve dhe ngjajshmërive në mes tyre.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Në fund të kursit pritet që studenti të jetë në gjendje të qartësojë, diskutojë për qështjet që kanë të bëjnë me financat publike: <i>Të njohurit:</i> Të definojë funksionimin e financave personale, të financave publike dhe të korporatave, dallimin në mes të tyre. Të identifikojë lidhur me funksionimin e financave publike në përgjithësi e në veçanti në Republikën e Kosovës, duke përfshirë sistemin tatimor e kategoritë e tjera financiare.

	<i>Të kuptuarit:</i> Të qartësojë se si bëhet shpërndarja e mjeteve buxhetore, përcaktimin e shpenzimeve publike, kategoritë shpenzuesve dhe politikat që aplikohen në plotësimin e nevojave. <i>Analiza:</i> Të analizojë burimet e të ardhurave në kufi dhe burimet e brendshme, strukturën e shpenzimeve duke i specifikuar, përfituesit buxhetor në bazë të kategorive ekonomike dhe klasifikimit funksional si dhe përcaktimet e pjesmarrjes së tyre në vlera absolute ashtu edhe relative. Të kategorizojë llojet e shpenzimeve, llojet e tatimeve, taksave e të doganave. Të debatojë mbi politikën e financave publike të cilat zhvillohen në Republikën e Kosovës, sistemin tatimor dhe ngarkesat fiskale duke bërë krahasimin me politikat e financave publike me Republikën e Shqipërisë dhe me vendet e rajonit e më gjërë, si dhe nevojat dhe kërkesat për të bërë reforma në këtë sistem dhe në këto politika. <i>Sinteza:</i> Të argumentojë se financat publike janë të lidhura ngusht me shtetin dhe funksionimin e tij. Por se edhe shteti funksionon me zhvillimin dhe rritjen e financave publike, të instrumenteve fiskale të cilat ndërtojnë dhe formojnë buxhetin e shtetit etj. <i>Vlerësimi:</i> Të konstatojë se sa është roli dhe rëndësia e financave publike në funksionimin e shtetit, formimin e të Ardhurave Kombëtare, pjesmarrja e tyre, rolin dhe ndikimin e tyre në zhvillimin ekonomik të vendit, rritjen ekonomike, punësimin etj. <i>Argumentimi:</i> Të vërtetojë se sa është zhvilluar sistemi dhe politika fiskale në vendin tonë dhe qëndrueshmëria fiskale në krahasim me vendet e tjera. Pas përfundimit të kursit, studentët njohurit që do të i marrin për sferën e financave publike do të iu shërbejnë edhe në praktikë, kur të punësohen në sektorin publik dhe privat, në qeveri, ATK-ës, Dogana, komunë e etj, në financa, kontabilitet e etj.		
Kontributi në ngarkesën e lëndës(të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë /javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	10 min	15	2.5
Kollokfiume, seminare	2	1	2
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	7	10	70
Përgatitja përfundimtare për provim	1	1	1
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	2	2	4
Projektet, seminare, prezantimet ,etj	30 min	1	0.5
Totali			125 orë = 5 ECTS (125 :25 = 5)
Metodologjia e mësimdhënies:	Metodologjia: Do të kemi ligjërata dinamike, shembuj praktikë rreth temave që		

	trajtohen. Studentët do të inkurajojmë të bëjnë punime seminarike për temat rreth financave publike, në grupe prej 2-3 student, prezentimet do të bëjnë gjatë ushtrimeve, Do mbahen dy kollokviume të cilat do të i kenë nga 20 pyetje në dy versione, nga te cilat 10 prej tyre do të jenë me shkrim, ndërsa 10 duke rumbullaksuar në kërkim të alternativës së saktë. Do të ndikoj dhe inkurajoj të zhvillohen debate mbi problemet mbi buxhetin e shtetit. Diskutimet do të zhvillohen edhe rreth aktualitetit dhe reformimit të sistemit tatimor. Do të kërkoja që studentët të jenë sa më shumë aktiv, sa më shumë të bëjnë pyetje për problemet që iu interesojnë. Studentet inkurajohen t'i përcjellin aktualitetin rreth zhvillimeve mbi politikat dhe sistemin e financave në vend dhe më gjërë. Edhe konsultime do të ketë me studentët jo vetëm pas mbarimit të kollokviumeve dhe provimit por sa herë që kanë interesim. Është mirë që studentët t'i lexojnë paraprakisht materialet për temat që trajtohen.
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i parë: 40% Vlerësimi i dytë 40% Vijimi i rregullt 10% Punimi seminarik 10% Total 100%
Literatura	
Literatura bazë:	Prof. Dr. Refik Kryeziu: Financat Publike, Prishtinë 2014.
Literatura shtesë:	1.Prof. Dr. Begjet Brajshori:Financat Publike,Prishtinë 2014. 2. Prof Dr Sabahudin Komoni: Financa Publike, 3. Hervej S.Rosen, Financa Publike. 4. Ligji mbi financat publike dhe përgjegjësitë. 5. Legjislacioni Tatimor i Republikës së Kosovës, Doracak
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Javët	Ligjërata që do të zhvillohen
<i>Java e parë:</i>	Prezentimi i Syllabusit –Kuptimi mbi Financat publike
<i>Java e dytë:</i>	Kuptimi, Klasifikimi i shpenzimeve sipas kategorive ekonomike
<i>Java e tretë:</i>	Shpenzimet publike sipas klasifikimit funksional.
<i>Java e katërt:</i>	Të ardhurat(hyrat) publike, llojet, karakteristikat,
<i>Java e pestë:</i>	Tatimet dhe sistemi tatimor, Parimet e tatimit.
<i>Java e gjashtë:</i>	Evazioni tatimor, Tatimi në pronë
<i>Java e shtatë:</i>	Kollukviumi i II
<i>Java e tetë:</i>	Doganat, llojet e doganave, Akciza.
<i>Java e nëntë:</i>	Taksat, llojet e taksave, kontributet
<i>Java e dhjetë:</i>	Buxheti i shtetit, funksionet, sistemi buxhetor
<i>Njëmbëdhjetë:</i>	Parimet e buxhetit.
<i>Dymbëdhjetë:</i>	Procesi planifikimit te buxhetit

<i>Trembëdhjetë:</i>	Sistemi buxhetor në Shqipëri dhe Kosovë
<i>Katërmbdhjetë:</i>	Borxhi publik, llojet e borxhit
<i>Pesëmbdhjetë:</i>	Kollukviumi i II

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studenti është i obliguar të vijojë ligjëratat dhe ushtrimet. Kodi e mirësjelljes vlen si për studentët ashtu edhe për mësimdhënësit.

Shkelja e integritetit akademik përfshinë një këti veprime në vijim:

- ☐ Kopjimi gjatë provimit ose testit;
- ☐ Shfrytëzimi i shenimeve ose librave të palejuara gjatë testit ose provimit;
- ☐ Shkëmbimi i informatave me një student tjetër gjatë provimit;
- ☐ Dhënja e deklaratave të rrejshme në lidhje me mësimin apo provimin.